

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 2 (dy) vende pune për personel ndihmësakademik (Laborant) në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit pranë Departamentit të Mekanikës së Strukturave:

A. Kandidatët për personel ndihmësakademik (Laborant) pranë Departamentit të Mekanikës së Strukturave në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të jenë diplomuar në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit në UPT apo në fakultete të huaja analoge në degët Ndërtim, Hidroteknik (diploma sipas sistemit 5 – vjeçar ose sistemit Bachelor +Master i Shkencave);
2. Të kenë njohuri të mira të programeve kompjuterike si Autocad, Word, Excel etj;
3. Të kenë eksperiencë në lidhje me procedurat e zhvillimit të provave laboratorike;
4. Preferohen kandidatët me njohuri të mira të gjuhëve të huaja si anglisht, frengjisht, italisht, gjermanisht etj.

II. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vende pune për personel ndihmësakademik (Specialist) në Institutin e Gjeoshkencave pranë Departamentit të Meteorologjisë:

A. Kandidatët për personel ndihmësakademik pranë Departamentit të Meteorologjisë në Institutin e Gjeoshkencave, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të kenë përfunduar studimet e larta sipas sistemit 4 – vjeçar ose sistemit 3+2 (Bachelor + Master i Shkencave) në Gjeografi, Inxhinieri Mjedisi;
2. Të kenë eksperiencë pune në fushën e meteorologjisë;
3. Të kenë aftësi të mira komunikimi dhe punës në grup.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **04.11.2022** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.